



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1708/4 Prot.,

Datë 21.09.2021

V E N D I M

Nr.655/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.09.2021 me

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-04470-09-02-2021, me objekt Loti 4 “Pajisje të Frymëmarrjes”, me fond limit/ me vlerë të pritshme të kontratës 7,515,360 (shtaë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 05.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “NënëTereza” Tiranë.

Vazhdimi i pocedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesave.

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Universitare “Nënë Tereza” Tiranë
Rruga e Dibrës nr. 372, Tiranë

Ankimues:

“O.E.S Distrimed” SHPK

Bulevardi: “Bajram Curri” Rruga “Nikollë
Kaçorri”, ND1, Tiranë

Baza Ligjore:

Nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për
Prokurimin Publik”, Vendimit të Komisionit të
Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë
12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për
organizimin dhe funksionimin e Komisionit të
Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.09.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-04470-09-02-2021, me objekt Loti 4 “Pajisje të Frymëmarrjes”, me fond limit/ me vlerë të pritshme të kontratës 7,515,360 (shtaë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 05.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “NënëTereza” Tiranë.

II.2. Në datën 10.09.2021 operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 1708/2 prot., datë 15.09.2021 i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” SHPK

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 2327/7 prot., datë 17.09.2021 protokolluar me tonën me nr. 1708/3 prot., datë 17.09.2021 me objekt “*Kthim përgjigje mbi formularin e ankesës së administruar pranë autoritetit kontraktor me nr. 2327prot., datë 10.09.2021 nga oe “O.E.S Distrimed” SHPK*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankësën e operatorit ekonomik ankimues “O.E.S Distrimed” SHPK dhe me shkresën 2327/7 prot., datë 17.09.2021 ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës (pika 1 e ankesës të publikuar në bazën e të dhënave të Komisionit të Prokurimit Publik).

Konkretisht, ankimuesi në pikën 1 të ankesës ka ankimuar “*Për artikullin 1 “Aspirator” kërkojmë që të rishikohen specifikimet pasi aspiratori nuk është një pajisje e cila ka modalitete të veçanta për të rritur, fëmijë apo neonatal. Qëllimi i aspiratorit është të thithë lëngjet, sekrecionet e trupit me një fluks e presion të caktuar. Pajisja aspirator është e përgjithsme dhe nuk jepen indikacione për grupmoshat e përdorimit. Gjithashtu kërkojmë të përcaktohen me numër madhësia e kanjulave të aspirimit të kërkuara. Përsa më sipër kërkojmë të hiqen specifikimet e mëposhtme si të panevojshme për këtë pajisje:*

Aspirator për adult dhe pediatrike

Aspirator neonat

Të jetë i përshatshëm për infant.

Të sqarohet specifikimi i mëposhtëm “2 koka silikoni”, nëse janë kanjula aspirimi të jepen përmasat e tyre:

Të shoqërohet me të paktën 2 koka silikoni.”

Në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton se autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht ankesën duke hequr specifikimet si më poshtë vijon:

-Aspirator neonat

-Të jetë i përshatshëm për infant.

Gjithashtu autoriteti kontraktor ka sqaruar në lidhje me:

Të shoqërohet të paktën 2 koka silikonit (adult dhe pediatrik)

DAk sqaron se Koka e silikonit është pjesa e konsumueshme, e cila mundëson thithjen e likideve të pacientit.”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumentave të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “O.E.S Distrimed” SHPK dhe me shkresën nr. 2327/7 prot., datë 17.09.2021, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës. (pika 1 e ankesës të publikuar në bazën e të dhënave të Komisionit të Prokurimit Publik). Konkretisht, ankimuesi në pikën 1 të ankesës ka ankimuar “Për artikullin 1 “Aspirator” kërkojmë që të rishikohen specifikimet pasi aspiratori nuk është një pajisje e cila ka modalitete të veçanta për të rritur, fëmijë apo neonatal. Qëllimi i aspiratorit është të thithë lëngjet, sekrecionet e trupit me një fluks e presion të caktuar. Pajisja aspirator është e përgjithsme dhe nuk jepen indikacione për grupmoshat e përdorimit. Gjithashtu kërkojmë të përcaktohen me numër madhësia e kanjulave të aspirimit të kërkuara. Përsa më sipër kërkojmë të hiqen specifikimet e mëposhtme si të panevojshme për këtë pajisje:

Aspirator për adult dhe pediatrike

Aspirator neonat

Të jetë i përshatshëm për infant.

Të sqarohet specifikimi i mëposhtëm “2 koka silikonit”, nëse janë kanjula aspirimi të jepen përmasat e tyre:

Të shoqërohet me të paktën 2 koka silikonit.”

Në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton se autoriteti kontraktor ka pranuar pjesërisht ankesën duke hequr specifikimet si më poshtë vijon:

-Aspirator neonat

-Të jetë i përshatshëm për infant.

Gjithashtu autoriteti kontraktor ka sqaruar në lidhje me:

Të shoqërohet të paktën 2 koka silikonit (adult dhe pediatrik)

Ak sqaron se Koka e silikonit është pjesa e konsumueshme, e cila mundëson thithjen e likideve të pacientit.”.

II.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115, pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115, pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-04470-09-02-2021, me objekt Loti 4 “Pajisje të Frymëmarrjes”, me fond limit/ me vlerë të pritshme të kontratës 7,515,360 (shtaë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë pa

TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 05.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “NënëTereza” Tiranë.

2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri